



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 63, paragrafi 4 i Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë dhe me nenin 5, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Rregullores së KQZ nr. 01/2024 për Regjistrimin dhe funksionimin e partive politike, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datë 10.07.2024, merr këtë:

## V E N D I M

### Për pezullimin e partisë politike Građanska Inicijativa Gore –GIG

- I. **Miratohet** rekomandimi i Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyra) për pezullim të partisë politike Građanska Inicijativa Gore për mos mbajtjen e Konventës zgjedhore për zgjedhjen e Kryetarit dhe organeve tjera të partisë.
- II. Partia politike politike Građanska Inicijativa Gore obligohet që në afat të shtuar prej dyzet e pesë (45) ditëve të mbajë Konventën zgjedhore.
- III. Obligohet Zyra të njoftojë përfaqësuesit e kësaj partie politike për marrjen e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Partia politike politike Građanska Inicijativa Gore me akronim GIG është regjistruar si parti politike me datën 08 Gusht 2002 me kryetar të partisë politike Redžep Kamberi. Në përputhje me nenin 12, paragrafi 1 i Rregullores Zgjedhore 01/2024 për Regjistrimin dhe funksionimin e partive politike, partia politike e regjistruar duhet që brenda gjashtë (6) muajsh nga data e regjistrimit dhe më pas çdo dyzet e tetë (48) muaj të mbajë Konventën zgjedhore për të zgjedhur Kryetarin e partisë dhe organet tjera. Partia Građanska Inicijativa Gore ka qenë e obliguar që Kuvendin e radhës ta mbajë me datën 20.06.2024. Zyra nuk ka pranuar njoftim për mbajtjen e Kuvendit apo ndonjë kërkesë për shtyrje të Kuvendit, sipas afateve të parapara në nenin 12, paragrafi 7, nënparagrafi 7.1 të Rregullores Zgjedhore 01/2024 për Regjistrimin dhe funksionimin e partive politike. Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 10.07.2024

Kryesues  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, sipas autorizimeve të përcaktuara me nenin 63.4 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë dhe me nenin 3, paragrafi 6 të Rregullës së KQZ nr. 01/2024 mbi Regjistrimin dhe Funksonimin e Partive Politike, me datë 10.07.2024 merr këtë:

## V E N D I M

### Për regjistrimin e partisë politike Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës-LPRK

- I. Regjistrohet partia politike Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës me akronim LPRK, me Kryetar z. Erxhan Galushi.
- II. Partia politike Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës, i ka përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe obligimet e përcaktuara me nenin 2 të Rregullës 01/2024 Për Regjistrimin dhe Funksonimin e Partive Politike.
- III. Partia politike Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës, obligohet që brenda gjashtë (6) muajve nga data e regjistrimit të mbajë Kuvendin në bazë nenit 12 të Rregullës 01/2024 Për Regjistrimin dhe Funksonimin e Partive Politike.
- IV. Obligohet Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike që të përgatisë certifikatën e regjistrimit dhe ta regjistrojë partinë politike Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës në Regjistrin e Partive Politike të Kosovës.
- V. Obligohet Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike që ta njoftoj partinë politike Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës, për marrjen e këtij Vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

Prishtinë, 10.07.2024

Kryesues  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

  
Kreshnik Radoniqi





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ)** sipas autorizimeve të përcaktuara me nenin 63.4 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë dhe në përputhje me paragrafin 8 të nenit 19 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike (LFSP) si dhe në bazë të rekomandimit të Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, me datën 10.07.2024, merr këtë:

## VENDIM

### Për privimin e subjektit politik PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM nga përfitimi i mjeteve financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike për vitin 2025

- I. Subjekti politik PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM, privohet nga përfitimi i mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike për vitin 2025, për shkeljen sipas paragrafit 8 të nenit 19 të nenit të LFSP.
- II. Obligohet Zyra t'i njoftojë përfaqësuesit e subjektit politik për marrjen e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Subjekti politike PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM, është subjekt politik i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi nga data 05.11.2010.

Sipas paragrafit 6 të nenit 19 të LFSP theksohet qartë subjekti i regjistruar politik bashkëpunon ngushtë me auditorët e përzgjedhur nga Zyra dhe u ofron atyre qasje të plotë dhe të papenguar në shënimet financiare të subjektit, duke përfshirë të gjitha shënimet pa kufizime.

Sipas paragrafit 8 të nenit 19 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, nëse auditorët arrijnë në përfundimin se subjekti politik nuk ka bashkëpunuar plotësisht, Zyra heton konkluzionin e auditorit në lidhje me mos bashkëpunimin dhe nëse konfirmohet konkluzioni i mos bashkëpunimit, KQZ sipas rekomandimit të Zyrës, nxjerr vendim për ta privuar subjektin në fjalë nga përfitimi i mjeteve financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike që ndahet nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin pasues.

Në lidhje me këtë, PARTIA E ASHKALINJËVE TË KOSOVËS, e cila përfaqësohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, përgjatë periudhës së auditimit 16.04.2024 – 25.06.2024, nuk ka bashkëpunuar me auditorin ligjorë.

Mos bashkëpunimi, vërtetohet përmes korrespondencës së e-mailave, ku auditori iu është drejtuar personave të autorizuar të subjektit politik PARTIA E ASHKALINJËVE TË KOSOVËS.

Auditori përmes e-mailit, të cilin e ka dërguar me datën 23.04.2024, në orën 11:47 në adresën elektronike të përfaqësuesit financiar të subjektit politik Rrahman Kadia, ka kërkuar informatat sipas listës së kërkesave për informacionin në lidhje me auditimit e pasqyrave financiare të subjektit politik për vitin 2023. Në lidhje me kërkesën e auditorit të parashtruar në e-mailin e kësaj date, përfaqësuesi financiar i subjektit politik, nuk iu është përgjigjur kërkesës së auditorit.

Auditori përmes e-mailit, të cilin e ka dërguar me datën 06.06.2024, në orën 12:11 në adresën elektronike të përfaqësuesit financiar të subjektit politik Rrahman Kadria dhe kryetarit të subjektit politik Hetem Arifi, iu është bërë me dije se nuk kanë pranuar asnjë dokument që shërben për auditimin e pasqyrave financiare 2023, deri me datën 06.06.2024 dhe i bëhet me dije që kërkesa për informacione iu është përcjellë tri (3) herë, deri me datën 06.06.2024 dhe janë njoftuar se raporti i auditimit do të hartohet vetëm me informacionin e publikuar nga KQZ. Në lidhje me kërkesën e auditorit të parashtruar në e-mailin e kësaj date, personat e auditorizuar të subjektit politik, nuk iu janë përgjigjur auditorit.

Auditori përmes e-mailit, të cilin e ka dërguar me datën 10.06.2024, në orën 13:03 në adresën elektronike të përfaqësuesit financiar të subjektit politik Rrahman Kadria dhe për kryetarin e subjektit politik Hetem Arifi, ka bashkangjitur raportin preliminar të auditimit dhe i ka ftuar që brenda afatit ligjorë prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh t'i japin komentet/korrigjimet në lidhje me të gjeturat e raportit. Në lidhje me kërkesën e auditorit të parashtruar në e-mailin e kësaj date, personat e auditorizuar të subjektit politik, nuk iu janë përgjigjur auditorit.

**Nga sa u tha më lartë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendos për marrjen e vendimit privimin e subjektit politik PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM nga përfitimi i mjeteve financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike për vitin 2025, sipas dispozitivit të këtij vendimi.**

Prishtinë, 10.07.2024

Kryesues  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

  
Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin nenin 59, 63 dhe 64 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 21 të Rregullores së Punës së KQZ, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 10.07.2024, nxjerr këtë:

## VENDIM

### Për Miratimin e Pjesëmrrjes në Udhëtimin Zyrtar në Republikën e Shqipërisë lidhur me Projektin “Transparenca Zgjedhore”

- I. Miratohet pjesëmarrja e delegacionit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Sekretariatit në udhëtimin zyrtar në Republikën e Shqipërisë në Tiranë, lidhur me projektin “Transparenca Zgjedhore”.
- II. Udhëtimi do të realizohet gjatë muajit Korrik.
- III. Obligohet Sekretariati për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 10.07.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64 dhe nenin 103 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 10.07.2024, nxjerr këtë:

## VENDIM

### Për Miratimin e Raportit për Asgjësimin/Shkatërrimin e Materialit të Procesit të Votimit për apo Kundër Largimit të Kryetarëve në Komunitet Leosavic, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë të Veriut

- I. Miratohet Rapori për Asgjësimin/Shkatërrimin e materialit të procesit të votimit për apo kundër largimit të Kryetarëve në komunitet Leosavic, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë të Veriut, të mbajtur më datën 21 prill 2024.
- II. Raporti, si në pikën I është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 10.07.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



<i>Data/Datum</i>	24.06.2024
<i>Për/Za</i>	Komisionin Qendror të Zgjedhjeve
<i>Permes/Preko</i>	Këshillit për Operacione Zgjedhore
<i>Nga/Od</i>	Nexhmedin Hyseni, Kryesues i Komisionit për Asgjësimin/Shkatërrimin e materialit të procesit të votimit për apo kundër largimit të Kryetarëve në komunat Leposavic, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë të Veriut
<i>Kopje/Kopija</i>	Arkivës së KQZ-së
<i>Lënda/Predmet</i>	Raport nga Komisioni për Asgjësimin/Shkatërrimin e materialit të procesit të votimit për apo kundër largimit të Kryetarëve në komunat Leposavic, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë të Veriut.

Të nderuar,

Në mbështetje të paragrafit 4 të nenit 103 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vendimit të KQZ-së Nr.01/825-2024 datë 16.05.2024, si dhe në mbështetje të pikës I dhe III të vendimit të Drejtorit të SKQZ-së Nr.02/954-2024 nxjerrë me datë 13.06.2024, Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (SKQZ) brenda afateve të parapara me planin e aktiviteteve për administrimin e procesit të votimit për apo kundër largimit të Kryetarëve në komunat Leposavic, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë të Veriut të 21 prillit 2024, përmes komisionit përkates për asgjësimin/shkatërrimin e materialit të procesit të votimit për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, të datës 21 prill 2024, në përbërje prej tetë (8) Anëtarëve;

1. Nexhmedin Hyseni, Kryesues,
2. Emira Alushi, Anëtar,
3. Naim Kaqiu, Anëtar,
4. Aleksandar Djokic, Anëtar
5. Betim Xhema, Anëtar,
6. Burim Lezi, Anëtar,
7. Islam Mema, Anëtar, dhe
8. Zoran Vasic, Anëtar.

Duke zbatuar piken II të vendimit në prezencën e menaxherit të kontratës Nr.320-24-4575-2-4-7/C236 Asgjësimi i Materialit Senzitiv me numër te brendshëm 320-24-014-

247, sot me datë 20.06.2024 në Depon Qendrore të KQZ-së në Objektivin e QNR-së duke filluar në ora 09:00, ka identifikuar të gjitha materialet, me pas ka verifikuar një nga një, dhe pas kësaj ka rekomanduar Operatorin Ekonomik të filloj asgjësimin/shkatërrimin e materialit, i cili në prezencë të komisionit ka asgjësuar materialin sipas vendimeve në lartshënim. Asgjësimi/shkatërrimi i materialit ka përfunduar në ora 11:55 të ditës së sotme.

Ndërsa, në zbatim të pikës III dhe IV të vendimit të KQZ-së Nr.01/825-2024 datë 16.05.2024 me datë 20.06.2024 janë asgjësuar/shkatërruar materialet zgjedhore zi në vijim:

1. Fletëvotime të vlefshme/të pavlefshme/ të zbrazëta/ të dëmtuara;
  2. Kopja dhe origjinali i Formularit i Rezultateve (FR);
  3. Lista e Gjerë e votuesve të komunave (Listat Komunale të Votuesve të shtypura)
  4. Lista Votuesve (LV) dhe Lista e Votuesve me Kusht (LVK);
  5. Librat e Votimit (LV);
  6. Fletëvotimet e papërdorura;
  7. Fletëvotimet me kusht;
  8. Vula zyrtare e fletëvotimit/vulat tjera- vula zyrtare e fletëvotimit pjesa e gomës;
  10. Materialet tjera informuese dhe
- Komisioni për asgjësimin/shkatërrimin e materialit, përgjatë verifikimit të materialeve në mënyrë fizike, sipas pikës 9 të vendimit KQZ-së Nr.01/825-2024 datë 16.05.2024 ka konstatuar se nuk ka material fare, e ketë e ka konfirmuar Drejtori i DOZIEAT-it z.Krasniqi, si dhe
  - Komisioni ka konstatuar se sipas pikës 11 të vendimit KQZ-së Nr.01/825-2024 datë 16.05.2024 ka konstatuar se, Drejtori i DTIZShV-së z.Spahiu, me datë 21.05.2024 (*përmes adresës elektronike*), ka njoftuar se konform vendimit të KQZ-së me numër të protokollit 01/825-2024, po në atë datë/ditë është bërë fshirja e regjistrimeve nga 67 kamerat e përdorura në ditën e votimit, me datë 21.04.2024.

***Në poshtëshënim është lista e materialeve sipas vendvotimeve, e ndarë me qendër të votimit, vendvotim dhe vitin zgjedhor, të cilat janë asgjësuar/shkatërruar.***



Nr. i QV	Kodi i Komunës/Opstinski Kod	Komuna/Opstina	Qendra e Votimit/Biracki Centar	Numri i vendvotimeve në QV	Vendvotimet (klasat)	Vendvotimit(s) sipas LV	Numri i votuesve në QV	Vendndodhja paraprake e Qendrave të Votimit/Preliminarna lokacija birackih centara	Lokacioni i Qendrës së votimit/Lokacija birackih centara	Objekt publik / privat
1	12	Leposaviq /Leposavië	1201	3	5	1201/01-1201/02-1201/03	2583	Leposaviq/Leposavië	Objekti Komunal - Leposaviq	Objekt publik
			1202	2		1202/01-1202/02	1703			
			VK-Le	1	1 kusht	LVK				
2	12	Leposaviq /Leposavië	1203	3	4	1203/01-1203/02-1203/03	2350	Soqanice/Soçanica	Objekt Komunal – Soqanice	Objekt publik
			1211	1		1211/01-1211/01	197	Borcani/Borçane		
			1214			336	Vuça/Vučë			
3	12	Leposaviq /Leposavië	1204	1	1	1204/01	920	Vraçevë/Vračëvo	Objekt Privat - Rëvatskë	Objekt privat
4	12	Leposaviq /Leposavië	1205	1	1	1205/01-1209/01-1212/01	350	Belloberdë/Belo Brdo	Objekt shtetëror – Dren	Objekt publik
			1209				485	Dreni/Dren		
			1212				156	Mikoviq/Mikoviçe		
5	12	Leposaviq /Leposavië	1206	3	4	1206/01-1206/02-1206/03	2728	Leshak/Lešak	Objekti i NSH Univerzall – Leshak	Objekt publik
			1210			107	Bistricë/Bistrica			
			1213	1	1210/01-1213/01-1215/01	350	Jarinje e Poshtme/Donje Jarinje			
			1215		214	Potkomlje/Potkomlje				
6	12	Leposaviq /Leposavië	1207	1	1	1207/01	63	Koshtovë/Košutovo	Objekt publik - Koshtovë	Objekt publik
7	12	Leposaviq /Leposavië	1208	1	1	1208/01-1216/01-1217/01	302	Jashanica/Jošanica	Objekt Privat - Leposaviq	Objekt privat
			1216				80	Kostin Potok/Kostin Potok		
			1217				442	Kjeviqë/Kjeviçe		
8	12	Leposaviq /Leposavië	1218	1	1	1218/01	308	Bistricë e Shalës/Sajjska Bistrica	Shkolla fillore "Kadri Bistrica" - Bistricë	Objekt publik
<b>LEP</b>					<b>18</b>					
1	28	Zubin Potok	2801	3	6	2801/01-2801/02-2801/03	2705	Zubin Potok/Zubin Potok	Objekti i Komunës - Zubin Potok	Objekt publik
			2802	1		2802/01-2803/01-2811/01	269			
			2803	1		357				
			2811	1		387				
			VK - ZP	1	1 kusht	LVK				
2	28	Zubin Potok	2804	1	1	2804/01-2812/01	406	Crepulë/Crepulja	Mala Jabuka	Objekt publik
			2812				89	Ceçeva/Ceçevo		
3	28	Zubin Potok	2805	1	1	2805/01-2806/01	378	Bubë/Bube	Te ura e Bubës	Objekt publik
			2806				211	Lluqkarekë/Luëka reka		
4	28	Zubin Potok	2807	1	1	2807/01-2810/01	420	Bërnjakë/Brnjak	Bërnjak	Objekt publik
			2810				126	Oklac/Oklace		
5	28	Zubin Potok	2808	1	2	2808/01	623	Zupë/Zupe	Shkolla fillore "Osman Rama" Çabër	Objekt publik
			2809	1		2809/01	906	Çabër/Cabra		
<b>ZUBI</b>					<b>11</b>					
1	29	Zveçan/Zvečan	2901	5	5	2901/01-2901/02-2901/03-2901/04-2901/05	4024	Zveçan/Zvečan	Objekti Komunal - Zveçan	Objekt publik
			VK-Zv	1	1 kusht	LVK				
2	29	Zveçan/Zvečan	2902	1	1	2902/01	246	Zhazha/Zaçë	SH.F.M.U. "Isa Boletini"/Osmanova Shkolla	Objekt publik
3	29	Zveçan/Zvečan	2903	1	1	2903/01	204	Lipë/Lipa	SH.F.M.U. "Isa Boletini"/Osmanova Shkolla	Objekt publik
4	29	Zveçan/Zvečan	2904	1	1	2904/01	650	Banjskë/Banjska	Rajsa Banja – Banjskë	Objekt publik
5	29	Zveçan/Zvečan	2905	2	3	2905/01-2905/02	1368	Zherovnicë/Zerovnica	Objekti Komunal – Zhitkove	Objekt publik
			2906	1		2906/01	717	Graboc/Graboc		
<b>ZVEÇAN</b>					<b>11</b>					
1	38	Mitrovicë e Veriut/Severna Mitrovica	3801	1	3	3801/01	937	Suhadoll/Suvi Do	Shkolla Fillore "Aziz Sylejmani" Suhadoll	Objekt publik
			3804	1		3804/01	160	Suhadoll i Epërm/Gornji Suvi Do		
			3807	1		3807/01	793	Mitrovica e Veriut/Severna Mitrovica		
2	38	Mitrovicë e Veriut/Severna Mitrovica	3802	2	2	3802/01-3802/02	1392	Lagja e Boshnjakeve/Bosnjacka Mahalla	Objekti Komunal	Objekt publik
3	38	Mitrovicë e Veriut/Severna Mitrovica	3803	2	2	3803/01-3803-01	1228	Kodra e Minatorëve/Rudarsko Brdo	Shkolla fillore "Aziz Sylejmani" – Kodra e Minatorëve	Objekt publik
4	38	Mitrovicë e Veriut/Severna Mitrovica	VK-MV	1	1 kusht	LVK		Mitrovica e Veriut/Severna Mitrovica	International Business College Mitrovica - IBCM -	Objekt publik
			3805	10	10	3805/01-3805/02-3805/03-3805/04-3805/05-3805/06-3805/07-3805/08-3805/09-3805/10	9253			
5	38	Mitrovicë e Veriut/Severna Mitrovica	3806	6	6	3806/01-3806/02-3806/03-3806/04-3806/05-3806/06	5033	Mitrovica e Veriut/Severna Mitrovica	Ish-Objekti Komunal	Objekt privat
<b>Mitrovicë e Veriut</b>					<b>23</b>					

Ndërsa, në vijim janë disa nga foto e bëra nga komisioni, si dëshmi se, si janë identifikuar, vlerësuar dhe ndarë materialet zgjedhore për asgjësim/shkatërrim;





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**38. MITROVICË E VERIUT/SEVERNA MITROVICA**



**3806/01**

**934**

Votues në listë  
Birača na spisku

**47**

Faqe të listës të votuesve  
Stranica biračkog spiska



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**KOMUNA / OPŠTINA**

**LIBRI I VOTIMIT  
KNJIGA O TOKU GLASANJA**

**(LIBRI I SHËNIMEVE NË VENDVOTIM)  
(KNJIGA ZAPISA SA BIRAČKOG MESTA)**

**21.04.2024**

**PROCESI I VOTIMIT PËR APO KUNDËR LARGIMIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS  
PROCES GLASANJA ZA ILI PROTIV RAZREŠENJA PREDSEDNIKA OPŠTINE**



38003101



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Central Election Commission



PROCESI I VOTIMIT PËR APO KUNDËR LARGIMIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS  
PROCES GLASANJA ZA ILI PROTIV RAZREŠENJA PREDSEBNIKA OPŠTINE


Mitrovica e Veriut  
Severna Mitrovica  
3805/01

A PAJTOHENI QË ERDEN ATIQ TË LARGOHET NGA FUNKSIONI  
I KRYETARIT TË KOMUNËS SË MITROVICËS SË VERIUT?

DA LI SE SLAŽETE DA ERDEN ATIQ BUDE RAZREŠËN  
FUNKCIJE PREDSEBNIKA OPŠTINE SEVERNA MITROVICA?

PO  
DA

JO  
NE





FLETËVOTIMET E DËMTUARA  
NEISPRAVNI GLASAÇKI LISTIÇI

Numri i vendvotimit:  
Broj biraçkog mesta:

2 8 0 1 / 0 1

7 Numri i fletëvotimeve të dëmtuara:  
Broj oštećenih glasačkih listića:

0 0 0

Subotika 7 e formularit të përshkrimit të M shprehim dhe rezultateve  
Kryetari 7 në shprehim të rezultateve / rezultate

FORMULARI I REZULTATEVE  
OBRAZAC ZA REZULTATE

KOMUNA / OPŠTINA

12 LEPOSAVIQ / LEPOSAVIĆ

Numri i vendvotimit  
Broj biraçkog mesta

1 2 0 6 / 0 1



Vetëm për QNR  
Samo za CPR



*Kopja me ngjyrë pembe ekspozohet në vendvotim, FPR-të e mbetura (përfshirë kopertinë) vendosen në Zarfën KKZ  
Shih udhëzimet mbi paketimin e materialeve të ndjeshme në anën e prapme të kopertinës*

*Kopiju roze boje izložiti na biračkom mestu, ostatak obrasca (uključujući korice) staviti u kovertu za OIK  
Pogledajte uputstva o pakovanju osetljivog materijala na zadnjim koricama*



Me respekt,